

per malje kje  
Sek. K. 5  
nfyf



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"  
VLORE  
ZYRA E PROTOKOLL - ARKIVËS  
NR. 1463 PROT.  
DATA 20.07.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE PËR ARSIMIN DHE SPORTIN

Nr. 4838/2 Prot.

Tiranë, më 28.7.2025

Lënda: Dërgohet urdhri për njohje dhe zbatim

**QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE**

Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark", Nr. 23, Tiranë

**QENDRËS NDËRINSTITUCIONALE TË RRJETIT AKADEMIK SHQIPTAR**

Adresa: Rruga e Durrësit Nr. 219, Tiranë

**AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

Adresa: Rruga e Durrësit Nr. 219, Tiranë

**UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORE**

Adresa: Skelë, Rruga "Kosova", 9401, Vlorë

Bashkëlidhur gjeni për njohje dhe zbatim urdhrin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 374, datë 28.7.2025 "Për hapjen e programit të përbashkët të studimit të ciklit të parë, Bachelor në "Shkenca Arkitekturore për Trashëgiminë" (Architecture Sciences for Heritage) në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë" me Universitetin Politeknik të Barit, Itali".

Duke ju falënderuar,

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

Erzen Tola





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 4838/ Prot.

Tiranë, më 28.7. 2025

URDHËR

NR. 374, DATË 28.7.2025

PËR

**HAPJEN E PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË,  
BACHELOR NË “SHKENCA ARKITEKTURORE PËR TRASHËGIMINË”  
(ARCHITECTURE SCIENCES FOR HERITAGE), NË UNIVERSITETIN “ISMAIL  
QEMALI”, VLORË ME UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË BARIT, ITALI**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 35, 73 dhe 80, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe shkronjës “g”, të pikës 2, të urdhrit nr. 113, datë 26.03.2024, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Ana Kapaj”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

- Hapjen e programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Shkenca Arkitekturore për Trashëgiminë” (Architecture Sciences for Heritage), me 180 kredite dhe kohëzgjatje 3 vite akademike (6 semestra), në gjuhën angleze, me formë studimi me kohë të plotë, me kod P63BA0730A.  
Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë e përbashkët “Bachelor” në “Shkenca Arkitekturore për Trashëgiminë” (Architecture Sciences for Heritage), në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë dhe në Fakultetin respektiv në Universitetin Politeknik të Barit, Itali, me referuar nivelit 6, të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
- Veprimtaria akademike në programin e përbashkët të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Shkenca Arkitekturore për Trashëgiminë” (Architecture Sciences for Heritage), në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore, në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë, fillon sipas legjislacionit në fuqi.
- Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, të marrë masa që programi i studimit t’i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
- Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtatë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.

5. Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilesise në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**ZËVENDËSMINISTRI**

**ANA KAPAJ**

